LIGJ
Nr.10 087, datë 26.2.2009

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8328, DATË 16.4.1998 "PËR TË DREJTAT DHE TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM DHE TË PARABURGOSURVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni l

Në fund të nenit 19 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

"Nëpunësit e administratës civile të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilët nuk bëjnë pjesë në strukturat e Policisë së Burgjeve, gëzojnë statusin e nëpunësit civil, sipas legjislacionit në fuqi dhe janë pjesë e shërbimit civil.

Marrëdhëniet juridike të punës për punonjësit mbështetës të administratës civile, në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe për punonjësit e administratës civile, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.".

Neni 2

Neni 22 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 22
Policia e Burgjeve

1. Policia e Burgjeve ka për mision ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, gjatë transferimeve e shoqërimeve të të dënuarve ose të të paraburgosurve, në gjykata e institucione të tjera, në përputhje me ligjin, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

2. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të Policisë së Burgjeve rregullohet me ligj të veçantë.".

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6094, datë 17.3.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi